

**GJYKATA THEMELORE-DEPARTAMENTI PËR ÇESHTJE EKONOMIKE NË PRISHTINË**, me gjyqtarin Murat Paçarada, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit, P.K.”I.” me seli në P., rruga “...”nr...., të cilën e përfaqësojnë Sh. I., përfaqësues ligjor nga P., kundër të paditurit, “T. G.” Sh.p.k. me seli në P.,”....”..,hyrja ...nr.. të cilën e përfaqëson V. K. nga P., për shkak të borxhit, vlera e kontestit, 250.000.00€ €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, në prezencën e të autorizuarit ligjor të paditësit Sh. I., e në mungesë të paditurit, me datën 07.02.2017 mori këtë.

### **A K T G J Y K I M**

**APROVOHET**, si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, “PK I.” me seli në P., Detyrohet i padituri, “T. G.” Sh.p.k. me seli në P., që paditësit t,ia paguaj borxhin në shumë prej 250.00.00€ €, me kamatë vjetore, sipas normës prej 8%, duke fillu nga dita e ushtrimit të padisë më 19.11.2015, e deri në pagesën definitive dhe t,ia kompenzoi shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumë prej 1.000.00€, të gjitha në afat prej 7 ditësh, pas plofuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

### **A r s y e t i m i**

Paditësi me padinë e ushtruar me datën 19.11.2015,ka kërkuar nga Gjykata, që të aprovohet kërkesëpadia, dhe të detyrohet e paditura “T. G.” sh.p.k. që paditësit t’ia kthej mjetet e huazuar në shumën prej 250.000.00€,me kamat ligjore nga data e lidhje së kontratës, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit.

E paditura në përgjigjen në padi, nuk e konteston borgjin e kërkuar nga pala paditëse, duke theksuar se është e vërtet e tera ajo që thuhet në padi, dhe se arsyeja e mospërmbushjes e detyrimit nuk qëndron se nuk deshijojm ta përmbushim obligimin por nuk kemi pasur mjete financiare.

Me datën 21.010,2016 gjykata e caktoj seancën përgatitorë lidhur me këtë çështje kontestuese, në të cilën nuk mori pjesë pala e paditur edhe pse ishte e thirrur në mënyrë të rregullt, por mungesën nuk e arsyetoj.

Me propozimin e palës paditëse kjo seancë u mbajt në mungesën e palës së paditur komfor nenit 409.2 të LPK-së.

Pala paditëse në këtë seancë i propozon gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia si e bazuar.

Pasi që vlera e kontestit ishte 250.000.00€,ndërsa pala paditëse nuk e kishte paguar taksen në vlerën e kontestit në këtë seancë gjykata e obligoj palën paditëse që këtë ta bejë në afatin prej 3 ditëve.

Sipas padisë së paditësit gjykata caktoi seancën për shqyrtimin kryesorë më datën, 02.12.2016, të cilën me propozimin e të autorizuarit ligjor të paditësit e në vështrim të

nenit 423.4, e mbajti në mungesët të autorizuarit të paditurit të ftuar në mënyrë të rregullt, në të cilën i autorizuari i paditësit deklaroi se mbetet në tërësi pranë theksimeve nga padia dhe seancat e kaluara, duke i propozu gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta provoi si të bazuar, nga se nga provat e bashkangjitura padisë, është dëshmu se i padituri nuk e përmbushi detyrimin e tij kontraktues kthimin e huas në vlerë të kërkesëpadisë.

Për të vërtetu bazushmërinë e kërkesëpadisë, në procedurën e administrimit të provave gjykata lexoi: marrëveshjen e datës 24.02.2011, aneks marrëveshjen e datës 17.05.2011, aneks kontratën –marrëveshjen e datës 05.01.2012, kontrata mbi huan me kompensim me nr.677-2012, nr.f.154/201, transferi bankar në shumën prej 150.00.00€, datë 25.02.2011, transferi bankar në shumën prej 100.000.00€, datë 25.02.2011.

Duke vlerësuar me ndërgjegje të secilës provë veç e veç, dhe të gjitha provave së bashku, konformë dispozitës së nenit 8. të LPK-ës, dhe fakteve jokontestuese, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

-Palët ndërgjyqëse kanë qenë në mardhënje kontraktuese-detyrimore, ashtu që paditësi merr për obligim për një investim prej minimum 250.000.00€, në ndertimin e objekteve banesore, afariste në lagjen “Dodona” në Prishtinë.

-Sipas marrëveshjes pala paditëse me datën 25.02.2011, ja ka paguar palës së paditur 150.000.00€,

-Po me të njëjten date 25.02.2011 pala paditëse, ja ka paguar palës së paditur edhe 100.000.00€

-Sipas aneks kontratës palët janë marrëveshje që “T. G.” sh.p.k. që borgjin prej 250.000.00€, ta kthejma së voni deri me datën 31.12.2011.

-Sipas një aneks kontrate tjetër palët mirren vesh që e paditura “T. G.” t’ia kthej borgjin palës paditëse sipas kësaj dinamike;

-Më së voni deri me datën 30.01.2012 shumën prej 60.000.00€,

-Më së voni deri me datën 01.03.2012 shumën prej 95.000.00€,

-Më së voni deri me 20.05.2012 shumën prej 95.000.00€

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike gjykata konstatoi që kërkesëpadia e paditësit në tërësi është e bazuar. Kjo nga se me dispozitën e nenit 17. par. 1 të LMD-së, është përcaktuar që pjesëmarrësit në marrëdhënie detyrimore janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre kontraktuese në mënyrën se si janë marrëveshje, dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre, ndërsa sipas dispozitës së nenit 262 të LMD-ës, kreditori në marrëdhënie detyrimore është i autorizuar që të kërkojë nga debitori përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori është i detyruar që detyrimin e tij ta përmbush në tërësi, ndërsa i padituri, nuk e kontestoi me asgjë se i ka pranuar 250.000.00€ nga paditësi, si dhe këtë borgj e ka pranuar. Edhe në përgjigjen në padi, por siç thekson nuk ka mundur me ja kthye paditësit mjetet monetare sepse nuk ka pasur mundësi, pra pala e paditur nuk e mohon borgjin, andaj gjykata, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, me ç’rast vendosi të dispozitivitet të këtij aktgjykimi.

Në shumën e gjykuar, gjykata e detyroi të paditurin, që paditësit t,ia paguajë edhe kamatën, duke fillu nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesen definitive, sipas normës prej 8%, e cila në vendin e përmbushjes paguhet për mjetet e deponuara, pa destinim të caktuar në afat prej më tepër se një vit, konformë dispozitës së nenit 277 par. 1 të LMD-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore u bazua në dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së, duke i përfshi shpenzimet e taksës për padi, në shumë prej 500.00 €, taksës për aktgjykim në shumë prej 500.00 €, gjithësejt në shumë të përgjithshme prej 1.000.00€

**GJYKATA THEMELORE- DEPARTAMENT PËR ÇESHTJE EKONOMIKE NË PRISHTINË**

**IV.EK.C.nr.518/15 të datës 07.02.2017**

Gjyqtari,  
Murat Paçarada

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.